



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe nenin 37.2 nën paragrafi (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.03.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. ARBËR VOKRRI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje -LVV" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Milot Podvorica.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z. Arbër Vokri, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 10.04.2018, nr.388/2018, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z. Milot Podvorica, pas dorëheqjes së tij të parevokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rënditur, i cili është, z. Arbër Vokri nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 28.03.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka